

Komunikatë për shtyp

## **IOM mbështet iniciativën për institucionalizimin e mësimit të gjuhëve zyrtare në Kosovë\***

### **Konferencë mbi të arriturat**

E hënë, 29 mars 2021

**Prishtinë** - Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) organizoi të hënën konferencën mbi të arriturat në lidhje me iniciativën për institucionalizimin e mësimit të gjuhëve zyrtare në Kosovë.

Konferenca bëri bashkë përfaqësuesit e lartë dhe akterët vendorë dhe ndërkombëtarë me qëllim të diskutimit të zhvillimeve kyçe dhe të planeve për të ardhmen. Qëllimi i iniciativës është që ta mundësojë mësimin kurrikular dhe jashtëkurrikular të gjuhëve zyrtare, si dhe ta mundësojë çertifikimin e njohurive gjuhësore. Një grup mbështetës ndërkombëtar (Ambasada Britanike, IOM dhe OSBE) ka punuar intensivisht me institucionet përkatëse (Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Filologjik, Ministrinë e Arsimit, Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve dhe Agjencinë e Akreditimit) për ta mbështetur fakultetin në procesin e përgatitjes së dokumentacionit për riakreditimin e programit të Ballkanistikës dhe rregulloreve për Qendrën e Gjuhëve.

Ngjarja u organizua nga Zyra e Komisionerit të Gjuhëve (ZKGj) dhe Fakulteti Filologjik në kuadër të projektit "Ndërtimi i lidhjeve shoqërore dhe mbështetja e pajtimit dhe kohezionit social" i cili është mbështetur nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe është zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM).

**Znj. Anna Rostocka**, Shefe e Misionit të IOM-it, mbajti fjalën hyrëse. "Projekti synon të kontribuojë në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse për të gjitha komunitetet në Kosovë duke i promovuar të drejtat e tyre gjuhësore, duke e nxitur bashkëpunimin dhe duke zhvilluar iniciativa të përbashkëta", - tha ajo.

"Ne e dimë që integrimi nuk është një proces standard i njëjtë për të gjithë. Integrimi është një çështje ndër-sektoriale dhe multi-sektoriale, që gjithashtu përcaktohet si proces i dyanshëm i përshtatjes së ndërsjellë, në të cilin komunitetet jo-shumicë përfshihen në jetën sociale, ekonomike, kulturore dhe politike të shoqërisë ", - shtoi ajo.

Si i tillë, integrimi përfshin një sërë përgjegjësish të përbashkëta që na ngarkohen të gjithëve dhe në këtë kuptim të zgjeruar përfshin nocione të tjera të ndërlidhura siç janë gjithëpërfshirja sociale dhe kohezioni social, - theksoi znj. Rostocka.

Duke e vlerësuar lart punën që është bërë në arritjen e progresit në këtë fushë me rëndësi thelbësore për shoqërinë, **znj. Arbërie Nagavci**, Ministre e Arsimit dhe Shkencës, tha se si ajo ashtu edhe Ministria të cilën e drejton, do të angazhohen në të siguruarit e mundësive të barabarta për të gjithë të rinjtë në të gjitha institucionet.

"Ndihma dhe kontributi që ju e jepni përmes këtij projekti besoj se do të jetë një ndihmë e madhe për institucionet tona në mënyrë që ato të jenë në gjendje t'i ofrojnë shërbimet e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme", - tha znj. Nagavci.

Duke i falënderuar organizatorët dhe të gjithë partnerët që po e zbatojnë projektin, ajo theksoi se komunikimi është urë që i lidh njerëzit.

\* Referencat për Kosovën do të kuptohen nga IOM në kontekstin e rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999).

"Gjuha si instrument i komunikimit është jashtëzakonisht e rëndësishme për t'i arritur qëllimet dhe zhvillimin tonë individual dhe shoqëror. Unë e konsideroj shumë të rëndësishme ndihmën dhe kontributin që ju po na e ofroni përmes këtij projekti, në mënyrë që qytetarët e Republikës së Kosovës të mund të bashkëpunojnë, ta njohin njëri-tjetrin dhe të përparojnë së bashku. Duke e njohur njëri-tjetrin, ne e kuptojmë njëri-tjetrin më mirë dhe arrijmë ta pranojmë njëri-tjetrin dhe të sigurohemi që të ndërtojmë ura bashkëpunimi, duke e mbështetur njëri-tjetrin dhe duke ecur së bashku përpara përmes dialogut në kapërcimin e dilemave ", - përfundoi Ministria.

**Rektori Naser Sahiti** theksoi se përfshirja e gjuhëve të komunitetit në arsimin e lartë është një nevojë dhe domosdoshmëri, si në nivelin shoqëror ashtu edhe në atë shkencor.

Rektori u shpreh se i ka mbështetur dekanët, duke thënë se do të ofrojë mbështetje për dekanen e Fakultetit Filologjik në këtë iniciativë, pra për Qendrën e Gjuhëve, duke theksuar se çdo sukses i Fakultetit Filologjik është edhe sukses i universitetit.

"Sigurisht, pjesë e strategjisë sonë si institucion arsimor është që këto iniciativa ta marrin formën e projekteve të përbashkëta që do ta rrisnin bashkëpunimin ndër-institucional me organizata dhe agjenci brenda dhe jashtë vendit në mënyrë që ta mbështesin zhvillimin e kulturave ekzistuese", - tha rektori.

**Dekanja Lindita Rugova**, njëra prej aktereve kryesore të projektit e rikujtoi zbatimin sfidues por të suksesshëm të projektit në sajë të forcave të bashkuara:

"Në vitin 2019 më është dashur t'ua shpjegoja akterëve se çfarë ishte një program i Ballkanistikës, nëpër çfarë procesi të gjatë kishim kaluar paraprakisht për ta përgatitur dokumentacionin për këtë program dhe tani thjesht mund t'jua konfirmoj se jemi në procesin e akreditimit. Jemi duke pritur që ekspertët e huaj ta rishikojnë programin, nëse marrim informata kthyesë pozitive prej tyre - për të filluar me programin në tetor 21/22. Në dhjetor të vitit 2019, në hapësirat e Fakultetit Filologjik, ku u takuam për herë të parë, arrita ta përmbledhë me një fjalë se krijimi i një Qendre të Gjuhëve në kuadër të Fakultetit Filologjik do ta mundësojë një qasje ndryshe në ofrimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare në lidhje me mësimin e gjuhëve në Kosovë dhe gjuhëve të tjera të huaja për të gjitha komunitetet në përgjithësi. Dhe tani para jush e kam vendimin për themelimin e Qendrës së Gjuhëve të aprovuar nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës.

Përveç kësaj, miqtë e grupit mbështetës të programit të Ballkanistikës gjithashtu ranë dakord për të hulumtuar në gjetjen e personelit të mundshëm mësimdhënës për ta mbështetur fakultetin në rivitalizimin e programit dhe të Qendrës së Gjuhëve.

Si rezultat i kësaj, z.Josip Lasić dhe znj. Ana Sivački shprehën interesin e tyre për të ardhur në Prishtinë dhe për të punuar si mësimdhënës me orar të plotë në Fakultetin Filologjik, e konfirmoi Znj. Rugova, gjersa shtoi se programi është në pritje të dritës jeshile nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Përveç kësaj, në vitin 2019 gjithashtu u diskutua riakreditimi i mundshëm i programit Master profesional për përkthim dhe interpretim. Tani, me mbështetjen e IOM-it dhe fondit të Ambasadës Britanike, grupi punues është duke punuar intensivisht në hartimin e këtij programi, duke krijuar një program Master profesional njëvjeçar që, siç tha dekanja, do t'i shërbejë së pari qeverisë për nevojat e saj për përkthyes dhe interpretë të ardhshëm në gjuhët zyrtare në Kosovë, si dhe për nevoja të tjera institucionale në përgjithësi.

"Si profesoreshë e gramatikës së tekstit, kur flas për të kaluarën dhe të tashmen duke e krahasuar tërë periudhën që nga viti 2019, nuk mund t'i lë jashtë këtij diskutimi mbi të ardhmen, modalitetet e mundshme për perspektivën e tanishme. Dhe kur flasim për modalitetet, ekziston një nevojë urgjente për ta mbështetur plotësisht Qendrën e Gjuhëve në mënyrë që ta krijojmë infrastrukturën e saj moderne dhe t'i ofrojmë shërbimet më të mira të mundshme. Hapësirat e përcaktuara për këtë njësi

\* Referencat për Kosovën do të kuptohen nga IOM në kontekstin e rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999).

të rëndësishme në kuadër të Fakultetit Filologjik tashmë janë përzgjedhur dhe nevojitet një rivitalizim rrënjësor në mënyrë që të ndryshohet pamja e saj dhe që puna e saj të jetë më efikase përballë publikut dhe akterëve të tjerë", - përfundoi znj. Rugova.

**Ambasadori Britanik, z. Nicholas Abbott** e përsëriti objektivin e përbashkët, që është përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike përmes avancimit të të drejtave gjuhësore. Prandaj, krijimi i Qendrës së Gjuhëve dhe programit për studime Ballkanistike janë një pjesë thelbësore e këtij zhvillimi.

"Gjuha është një aspekt i jetës njerëzore që ose i ndan ose i lidh njerëzit," - tha ai në konferencë.

"Ka shumë arsye objektive pse Qendra e Gjuhëve dhe programi i Ballkanistikës duhet të themelohen dhe të mbështeten nga të gjitha institucionet përkatëse, por unë do t'i përmend vetëm dy. Së pari, natyrisht Ligji për Përdorimin e Gjuhëve thotë se dokumentet zyrtare duhet të përkthehen në të dyja gjuhët zyrtare. Mendoj se të gjithë e dimë që shpesh nuk është kështu - ato ose nuk përkthehen fare, ose përkthehen por jo si duhet. Sidoqoftë, qasja e barabartë në shërbime dhe informata në gjuhët zyrtare është thelbësore për të gjithë qytetarët, veçanërisht gjatë periudhave si kjo e pandemisë kur njerëzit mbështeten në informata zyrtare. Së dyti dhe po aq i rëndësishëm, është komunikimi midis njerëzve, komuniteteve dhe fqinjëve. Kjo është e rëndësishme në Kosovë por edhe në secilin shtet tjetër ku ka njerëz që flasin gjuhë të ndryshme, por të cilët jetojnë pranë njëri-tjetrit dhe kanë nevojë të komunikojnë" – ishin komentet e tij.

Z. Abbott vuri në pah rëndësinë e një komponenti tjetër të suksesshëm të projektit gjuhësor të IOM - Platforma e gjuhës The VocUp, që është mbështetur gjithashtu nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar. "Një sondazh që është bërë me pjesëmarrësit e kursit të gjuhës The VocUp tregoi se ndërveprimi shoqëror midis komuniteteve dhe rritja e mundësive për punësim ishin renditur si nxitësit kryesorë për mësimin e gjuhëve të komunitetit", - tha ai.

Shkëlqesia e tij i renditi problemet kyçe në këtë fushë: numrin e pamjaftueshëm të profesionistëve gjuhësorë, mungesën e fondeve për shërbimet e përkthimit, mospërputhjen në legjislacion, por edhe çështjen e njohjes reciproke të diplomave midis Serbisë dhe Kosovës.

"Të gjitha këto sfida duhet të adresohen si duhet dhe unë e mirëpres punën me qeverinë e re për ta bërë një gjë të tillë," - përfundoi z. Abbott.

**Ambasadori i OSBE-së në Kosovë, Michael Davenport**, në fjalimin e tij të parë publik që nga marrja e detyrës një javë më parë, përgëzoi akterët për sukseset e arritura deri më tani përmes këtyre përpjekjeve të përbashkëta.

Ai ishte veçanërisht i kënaqur që pas iniciativës së Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare kishin pasuar rezultate konkrete, derisa OSBE-ja e kishte mbështetur në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme projektin në tërësi në Kosovë.

Në pozitën e tij të mëparshme si Ambasador i BE-së në Beograd, ai gjithashtu punoi shumë ngushtë me një komisioner të lartë në krijimin e një fakulteti shumëgjuhësor të ekonomisë në Bujanovc. Megjithëse u deshën shumë vite pune intensive, tani po dëshmohet kontributi i madh në pasurimin e jetës së të rinjve në atë zonë, tha z. Davenport, duke e rikujtuar suksesin e tij. Me të njëjtën mbështetje u angazhua edhe në detyrat e reja:

"Unë besoj që ky është pikërisht ai lloj investimi që nevojitet për të rinjtë në këtë rajon. Kështu që unë e mirëpres angazhimin e Qeverisë dhe të Universitetit të Prishtinës në krijimin e programit të studimeve të Ballkanistikës dhe të Qendrës së Gjuhëve (...) Ideja është që programi i studimeve të Ballkanistikës me të vërtetë ta krijojë një lloj kanali përmes së cilit do të dalin interpretë profesionistë dhe efikas, si në qeveri ashtu edhe në sektorin privat".

\* Referencat për Kosovën do të kuptohen nga IOM në kontekstin e rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999).

"Ju lutem dekane llogarisni në mbështetjen time si një mik i studimeve të Ballkanistikës", - theksoi z. Davenport.

**Koordinatorja për Zhvillim e KB në Kosovë, Ulrika Richardson**, që tashmë është në Kosovë që tre vite, tha se një nga pengesat më të mëdha për komunikimin dhe ndërveprimin e të rinjve në Kosovë është pengesa gjuhësore, duke shtuar se ky duhet të jetë prioriteti kryesor për ecur më tej.

"Besoj se të gjithë pajtohem se gjuha është me të vërtetë ura më e mirë lidhëse që mund ta mendojmë midis njerëzve. Gjuha na lejon jo vetëm që të lidhemi intelektualisht, por që të lidhemi edhe emocionalisht."

Sipas znj. Richardson, ta mësosh një gjuhë do të thotë të përpiqesh ta kuptosh anën tjetër dhe kjo shkon drejtpërdrejt në thelbin e kohezionit social.

Kështu, ajo theksoi se institucionalizimi i mësimit të gjuhëve zyrtare dhe iniciativa e krijimit të një Fakulteti Ballkanistik në Universitet janë jashtëzakonisht të rëndësishme.

Pas folësve kyç, u prezantua raporti i vlerësimit mbi nevojën për profesionistë gjuhësorë, i cili u pasua nga një panel diskutimi dhe nga një sesion i moderuar pyetjesh dhe përgjigjesh me audiencën që ishte po ashtu e pranishme online.

Gjetja kryesore e raportit është se numri i profesionistëve gjuhësorë që janë të punësuar aktualisht në institucionet qendrore dhe lokale, si dhe në sektorin e drejtësisë dhe në atë privat është nën pragun e nevojave aktuale.

Në Kuvend, në Ministri, në Zyrën e Presidentit, në KQZ dhe në zyrën e Ombudspersonit janë të punësuar 64 përkthyes dhe interpretë që janë të certifikuar dhe kanë bërë trajnim adekuat profesional dhe akademik, ndërsa nevoja aktuale është 104. 63 janë të punësuar në kuadër të institucioneve në nivel lokal, ndërsa nevoja aktuale është 128. Në gjykata dhe shërbime të prokurorisë janë të punësuar 77, kurse 110 janë të nevojshëm gjithsej. 15 përkthyes dhe interpretë të tjerë janë të angazhuar me agjenci private të përkthimit dhe me kompani në treg, ndërsa nevoja është për 57 gjithsej. Kjo mospërputhje do të jetë edhe më e dukshme në të ardhmen, kur pritet një ngarkesë më e madhe e punës dhe kur shumë prej përkthyesve do ta arrijnë moshën e pensionimit. Raporti ka parashikuar që nevoja për angazhim të profesionistëve gjuhësorë për një periudhë prej 5 deri në 10 vite të jetë 168 profesionistë gjuhësorë në kuadër të institucioneve në nivel qendror, 204 në kuadër të institucioneve të nivelit lokal, 147 në departamentet e drejtësisë dhe 100 në sektorin privat.

Në diskutim kontribuan edhe zyrtarë të tjerë ndërkombëtarë dhe qeveritarë të nivelit të lartë, duke e theksuar kështu rëndësinë e kësaj iniciative dhe duke e shprehur përkushtimin e tyre për ta mbështetur zhvillimin e saj të mëtejshëm.

*Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni Safete Graicevci në ZKGJ, në email: [Safete.Graicevci@rks-gov.net](mailto:Safete.Graicevci@rks-gov.net), Dorina Decani në FP, email: [dorinadecani@gmail.com](mailto:dorinadecani@gmail.com) ose Igor Rašić në IOM Prishtinë, email: [irasic@iom.int](mailto:irasic@iom.int).*



\* Referencat për Kosovën do të kuptohen nga IOM në kontekstin e rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999).

\* Referencat për Kosovën do të kuptohen nga IOM në kontekstin e rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999).